



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2958/ 5 prot.

Datë 07/11/2025

V E N D I M
Nr. 1618/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07/11/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “METEO” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas

loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “METEO” SHPK me NIPT: L26310801C dhe me adresë: *Pishaj, Cekin, Rruga Gramsh Elbasan.*

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”, Vlorë..

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.10.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 21.10.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5983, datë 21.10.2025 dhe me nr. 2958/2025 prot., datë 21.10.2024 e operatorit ekonomik “METEO” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datë 24.10.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, ku informon lidhur me vendimarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “METEO” SHPK, në të cilin

konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

“Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për pretendimin nr.2 të ankimuesit:

2. Në pikën 2.3.6 “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim, transportim dhe depozitimi i dherave dhe mbetjeve inerte”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme. Mbështetur në ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”).

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën Kodi III.2.A “Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas tabelës së ndarjes së punimeve të marra përsiper dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ose të paraqesë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara për Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujerave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A.”.

Kërkesa e mësipërme për licencën Kodi III.2.A “Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” është jo e saktë, pasi vlerësimi i ndikimit në mjedis është bërë në fazën e Hartimit të Projektit. Kërkojmë që kjo pikë të hiqet.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ose të paraqesë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara për Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujerave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A. Kërkojmë që kjo pikë të hiqet, pasi është shfuqizuar.

Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për licencën me Kodin III.2.A dhe licensën me Kodin III.1.A, ne si KSHA, pasi u konsultuam me bazën ligjore në fuqi konstatojmë se pretendimi i operatorit ekonomik në këtë pikë është i drejtë, pasi licenca III.2.A është shfuqizuar, me anë të Ligjit Nr. 12872020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar”.

Pretendimi i operatorit ekonomik pranohet.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “METEO” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, dhe konkretisht për sa i përket kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të Shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, lidhur me kërkesën për heqjen e kriterëve kualifikuesë për paraqitjen e licencës Kodi III.2.A “*Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis*”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme dhe për paraqitjen e Lejes mjedisore e tipit “C” për “*Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujerave të zeza urbane*” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A, të parashtruara në pretendimin nr. 2 në formularin e ankesës të ankimit elektronik me A/2025/5983, datë 21.10.2025 dhe me nr. 2958/2025 prot., datë 21.10.2024, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “*Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “METEO” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

“Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për pretendimin nr.2 të ankimuesit:

2. Në pikën 2.3.6 “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim, transportim dhe depozitimi i dherave dhe mbetjeve inerte”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme. Mbështetur në ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”)*.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën Kodi III.2.A “Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas tabelës së ndarjes së punimeve të marra përsiper dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ose të paraqesë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara për Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujerave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A.”.

Kërkesa e mësipërme për licencën Kodi III.2.A “Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” është jo e saktë, pasi vlerësimi i ndikimit në mjedis është bërë në fazën e Hartimit të Projektit. Kërkojmë që kjo pikë të hiqet.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ose të paraqesë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara për Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujerave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A. Kërkojmë që kjo pikë të hiqet, pasi është shfuqizuar.

Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për licencën me Kodin III.2.A dhe licensën me Kodin III.1.A, ne si KSHA, pasi u konsultuam me bazën ligjore në fuqi konstatojmë se pretendimi i operatorit ekonomik në këtë pikë është i drejtë, pasi licenca III.2.A është shfuqizuar, me anë të Ligjit Nr. 12872020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar”.

Pretendimi i operatorit ekonomik pranohet.”.

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se :

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

III.1.4. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “METEO” SHPK, lidhet me kërkesën për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të Shtojcës 7 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit object ankimi, lidhur me kërkesën për heqjen e kriterëve kualifikuesë për paraqitjen e licencës Kodi III.2.A “Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme dhe për paraqitjen e Lejes mjedisore e tipit “C” për “Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A, ku për këto pretendime të ankimuesit Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor referuar shkresës nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, ka vendosur që ti pranojë këto pretendime të ankimuesit.

Duke qenë, se pretendimet e mësipërme i operatorit ekonomik ankimues janë pranuar nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, pasi gjykon, se vendimi i dhënë nga KSHA është shterues dhe pranues për operatorin ekonomik ankimues për këto pretendime të tij.

Gjithashtu Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, duhet të hartojë dhe publikojë shtojcën e modifikuar, me qëllim që si operatori ekonomik ankimues dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime.

Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “METEO” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “METEO” ShPK ku kërkon: “Si operator që duam të marrim pjesë në procedurën e mësipërme pasi shqyrtoam Dokumentat Standarte të Tenderit, Projektin e Zbatimit dhe Preventivin, vumë re se disa nga Kriteret e veçanta janë jashtë natyrës së objektit dhe llogjikës.

Konkretisht :

1. 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf /Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Hidrogjeolog 1 (një)

Në Procesverbalin e Argumentimit keni argumentuar se

- Ing. Hidrogjeolog është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidrogjeologjike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.

Referuar Projektit dhe Preventivit nuk del e nevojshme prania e një inxhinieri të tillë. Arsyetojmë se është i mjaftueshëm ing Hidroteknik dhe inxhinieri Gjeoteknik. ose të kërkohet inxhinier gjeolog, pasi nuk ka punime me natyrë Hidrogjeologjike.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf /Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Hidrogeolog 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, diplomë universitare, librezë pune dhe CV

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin”.

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- Ing. Ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
 - Ing. Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
 - Ing. Elektrik është përgjegjës për zbatimin e punimeve. Është kërkuar Inxhinier Elektrik, pasi shoqëria jep informacionin e duhur për aktivitetin që është menduar të kryhet në përputhje me faktin se punimet kryhen në rrugë ekzistuese në prezencë të kabllorëve nëntokësorë elektrike, telefoni, interneti etj., si dhe për zhvillimin e aktivitetit që do të jetë në përputhje me kriteret për të mos shkaktuar dëmtime gjatë zbatimit dhe zhvillimin e aktivitetit nevojitet eksperiencia profesionale e Inxhinierit Elektrike.
- AK argumenton se kërkesa për inxhinierin elektrike është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.
- Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.
 - Ing. Gjeoteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve gjeoteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë
 - Ing. Hidrogeolog është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidrogeologjike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
 - Ing. Mjedisori është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve mjedisore duke pasur punime për rehabilitim skarpatah, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.”.

III.2.3. Në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin e zërave të punimeve objekt prokurimi, si vijon:

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
		1. PUNIME SHITESASH				
1	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	119,88442		
2	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur ngjeshur me makineri	m2	155		
3	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	145		
4	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	52		
5	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	52		
6	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	94		
7	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	235		
8	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges,perhapur e ngjeshur me makineri	m3	1672		
9	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	216		
10	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	94		
11	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	94		
12	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	3036		
13	3.212/fd	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	3036		
14	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	3036		
15	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	1114		
16	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me	m3	911		

		<i>makineri</i>				
		SHUMA 1:				
		2. PUNIME SHITRESASH 2				
17	2.261	<i>Shtrese rere</i>	<i>m3</i>	382		
		SHUMA 2:				
		3. PUNIME GERMIMI				
18	3.158/3a	<i>Transport dheu me auto deri 3.0 km</i>	<i>m3</i>	1493,122		
19	3.158/3a	<i>Transport dheu me auto deri 3.0 km</i>	<i>m3</i>	3711		
20	3.158/3a	<i>Transport dheu me auto deri 3.0 km</i>	<i>m3</i>	10443		
		SHUMA 3:				
		4. PUNIME ASFALTIMI				
21	3.213	<i>Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri</i>	<i>m2</i>	88		
22	3.213	<i>Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri</i>	<i>m2</i>	94		
23	3.213	<i>Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri</i>	<i>m2</i>	3036		
		SHUMA 4:				
		5. ANALIZA TEKNIKE TE REJA 4				
24	4.19	<i>Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.</i>	<i>ml</i>	1196		
		SHUMA 5:				
		6. ANALIZA JASHTE LISTE				
25	An 3.69/b	<i>Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m</i>	<i>m3</i>	2504		
26	An-PL	<i>F.V. Palankola metalike tip Larsen 603 K</i>	<i>m2</i>	1445		
27	An-8	<i>Mbushje me material te granular, anash dhe mbi boksine beton-arme sipas seksionit terthor tip</i>	<i>m3</i>	1320		
28	An.B	<i>Furnizim vendosje box beton/arme 1800x1800 mm</i>	<i>ml</i>	281		

29	An-P4	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=30cm	copë	7		
30	An-3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	5282,74347		
31	An-PL	F.V Palankola per mbrojtjen e skarpatave hmes =3.74 m	m2	3323		
32	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi boksen beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	941		
33	An-B	Furnizim vendosje box beton/arme 2000x2000 mm	ml	362		
34	An-P5	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=40cm	copë	4		
35	An-3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	11354		
36	An-PL	F.V Palankola per mbrojtjen e skarpatave hmes =3.74 m	m2	6238		
37	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi boksen beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	2502		
38	An-8	Furnizim vendosje box beton/arme 2400x2000 mm	ml	834		
39	An-5	Pusete deri ne 2.5-3.5 m thellesi t=40cm	copë	1		
40	An-P5	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=40cm	copë	9		
		SHUMA 6:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Totali						

III.2.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “METEO” ShPK Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 17458 prot, datë

23.10.2025 “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, ka argumentuar si më poshtë vijon;

“...Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik për lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për Inxhinierin Hidrogeolog, sqarojmë:

Pse është i nevojshëm një inq.Hidrogeologjik tek KUB

Në raportin gjeologjik theksohen qartë disa elemente të natyrës hidrogeologjike, që kanë ndikim direkt në sigurinë e veprës:

1. Prania e ujërave nëntokësore të cekëta (1.2—3 m)

- Kërkon analizë hidrodinamike për të përcaktuar presionet në themel dhe ndikimin gjatë gërmimit.

2. Koeficientët e filtrimit dhe tipi i akuiferëve (0.2—1.5 m/ditë)

- Duhet analizë e lëvizjes së ujit në rërë—argjilë, përcaktimi i rrezikut të likuefaksionit dhe ngopjes së themelit.

Kjo është pjesë e studimit hidrogeologjik, jo thjesht gjeoteknik.

3. Ndryshimet sezonale të nivelit të ujërave (0.7—1.7 m)

- Ndikon në thellësinë e gropave të gërmimit, në stabilitetin e sheet-pile-ve dhe në projektimin e drenazhit.

Vetëm hidrogeologu ka përgatitjen për modelimin sezonal të këtij niveli.

4. Depozitat argjilore—siltoze dhe ranoro—argjilore

- Kanë rrezik tkurrje, bymimi dhe shpëlarje (sufuzion) — fenomene që varen nga përmbajtja ujore dhe lëvizja e ujit nëntokësor.

Kërkojnë analizë hidrogeologjike të shtresave për të vlerësuar stabilitetin afatgjatë.

5. Uji me përbërje hidrokarbonat—kalciun (jo agresiv)

- Edhe ky element është përcaktuar nga analiza hidrokimike, që kërkon kompetencë hidrogeologjike.

Në këtë rast, raporti gjeologjik tregon qartë se:

Terreni është i ngopur me ujë,

Prezanton akuiferë të lirë dhe nën presion,

Ka rrëshqitje të mundshme, bymim argjilor dhe sufuzion,

Dhe ndërhyrjet ndërtimore kërkojnë menaxhim të nivelit të ujërave nëntokësore.

Këto kushte nuk mund të analizohen dhe menaxhohen nga një inxhinier hidroteknik ose gjeolog i vetëm, sepse ata nuk kanë formim në hidrodinamikën nëntokësore dhe hidrostatikën e mediave poroze.

Prandaj kërkesa për inxhinier hidrogeolog nuk është e tepërt, por e detyrueshme sipas natyrës së terrenit, ligjeve në fuqi dhe standardeve të projektimit.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.”.

III.2.4. Në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar dokumentin “Raporti gjeologjik”, duke njohur operatorët ekonomikë ofertues lidhur me stugimin gjeologjik dhe gjeoteknik të kolektorëve të ujrave të bardha të projektit objekt prokurimi, ku në seksionin “PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME” ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në vendin e ndërtimit do të hasen kushtet e mëposhtme:

- ✓ *Depozita kënetore–liqenore dhe detare Q4, të përfaqësuara nga rëra ranoro–argjilore dhe struktura me kokrriza të imëta deri pluhur, mesatarisht të ngjeshura, të ngopura me ujë, dhe argjila sipërfaqësore, si dhe mbushje antropogjene; ato paraqiten më qartë në këtë dokument dhe në profile.*
- ✓ *Niveli i ujit ndodhet në thellësi 1.2 m – 5 m nën nivelin e tokës.*
- ✓ *Rekomandohet përdorimi i gropave të përforcuara me fletë metalike (sheet piles) përpara fillimit të punimeve të tubacionit, për shkak të strukturës jo të qëndrueshme të kushteve të tokës si rezultat i pranisë së ujërave nëntokësore.*
- ✓ *Rekomandohet që, për gërmime me thellësi të mëdha, punimet e ndërtimit të kryhen në prani të specialistit gjeolog.”*

III.2.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmanjin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.7. Në nenin 15, pika 1 dhe pika 2 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

- “1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.
2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

Ky informacion përfshin të paktën:

- njoftimin paraprak të informacionit/njoftimin periodik të informacionit;
- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- deklaratën e informacionit konfidencial;

- formularin e ofertës ekonomike;
- sigurimin e ofertës;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- njoftimin e fituesit;
- formularin e ankesës;
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e lidhjes së kontratës;
- njoftimin e anulimit të procedurës.”.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;

- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e livrimit
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.”.

III.2.8. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.10. Në KREUN I “QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLORES DHE PËRKUFIZIME” pika 1, KREUN III “KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET” pika 1 dhe pika 2, KREU IV “DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË” pika 1/a të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet se:

[...]

KREU I

QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLORES DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi dhe fusha e veprimit:

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësisë që ka subjekti i pajisur me licencë.

Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij.

Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

c) Shfuqizuar.

ç) Shfuqizuar.

d) Autoriteti kontraktues kërkon ndërprerjeje e punimeve dhe prishjen e kontratës për çdo vonesë në grafikun e punimeve, që rrezikon përfundimin e punimeve në afatin përfundimtar, të përcaktuar në kontratën e nënshkruar. Në këtë rast edhe për moskryerje të punimeve sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën “c” kërkohet heqja e licencës për shoqëri ndërtuese, në përputhje me këtë vendim dhe përjashtimin e saj nga prokurimet publike, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

2. Elementet e licencës:

a) Licenca përmban këto elemente:

I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2);

II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4);

III. Numrin e identifikimit;

IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni);

V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë;

VI. Selinë;

VII. Afatin e vlefshmërisë;

VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit;

IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).

b) Formulari i licencës miratohet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.

KREU IV

DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.”.

Në lidhjen nr. 5 janë përcaktuar llojet e arsimit universitar që duhet të kenë mbaruar individët që do të ushtrojnë detyrën e drejtuesit teknik, si më poshtë:

LIDHJA 5

Nr.	Titulli i diplomës Universitare	Dega
1	Ndërtim	Ndërtim para vitit 1971
2		Qytetare Industriale
3		Civile Industriale
4		Përgjithshëm
5		Strukturist
6		Transport e Infrastrukturë
7		Civile Industriale Ura
8		Rruga Ura
9		Rruga Ura e Vepra nëntokësore
10		Hidroteknik
11		Hidroteknik Rruga Ura
12		Gjeodezi
13		Mjedis
14		Arkitekturë para viteve 85
15	Mekanik	Degë të Inxhinierisë mekanike
16	Elektrik	Degë të inxhinierisë elektrike
17	Gjeologji	Gjeolog
18		Ndërtim miniere
19		Markshajder

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.2.12. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*” të Shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në stafin kryesorë si drejtues teknikë dhe të pasqyruar në licënsën profesionale personat të diplomuar në fushat si në vijim: “1 (një) *Inxhinier Gjeodet ose Topograf ose Markshajder*; 1 (një) *Inxhinier Ndërtimi*; 1 (një) *Inxhinier Hidroteknik*; 1 (një) *Inxhinier Gjeoteknik dhe 1 (një) Inxhinier Mjedisi*.”, ndërkohë që njëkohësisht ka përcaktuar që operatorët ekonomikë ofertues në stafin inxhinierik të ketë të punësuar personat të diplomuar në fushat si në vijim: “1 (një) *Inxhinier Ndërtimi*; 1 (një) *Inxhinier Elektrik dhe 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog*.”.

Lidhur me këtë kriter kualifikues, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues pretendon se kërkesa që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin inxhinierik 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog është një kërkesë e paargumentuar, pasi referuar projektit dhe preventivit të zërave të punimeve objekt prokurimi prania e një inxhinieri Hidrogeolog është i panevojshëm për kryerjen e zërave të punimeve të preventivit të publikuar.

Për këtë pretendim të ankimuesit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “*Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025 ka argumentuar se inxhinieri Hidrogeolog është i nevojshëm për realizimin e punimeve objekt prokurimi, pasi referuar dokumentit “*Raporti gjeologjik*” punimet objekt prokurimit do të kryhen në një terren të veçantë, ku ka prani të ujërave nëntokësorë të cekëta në thellësinë 1.2 – 3 metra, ku koeficientët e filtrimit dhe tipi i akuiferëve është në intervalin e prurjeve 0.2 – 1.5 metra në ditë, ku dryshimet sezonale të nivelit të ujërave është në intervalin 0.7 – 1.7 metra, ku ka depozitime të materialeve “*Argjilore – siltoze*” dhe materialeve “*Ranoro – argjilore dhe ku uji i pranishëm është me përbërje “Hidrokarbonat – kalciumi”, ndaj për shkak të natyrës së veçantë të këtij terreni është e nevojshme prania e inxhinierit hidrogeolog për të grantuar sigurinë e punimeve objekt prokurimi, ndërkohë referuar përcaktimeve të bëra nga kompania e specializuar që ka hartuar dokumentin “Raporti gjeologjik”, Komisioni konstaton se kjo e fundit në seksionin “PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME” të këtij dokumenti i ka rekomanduar autoritetit*

kontraktor që për zërat e punimeve “Gërmime në thellësi” punimet ndërtimore duhet të kryhen në praninë e specialistit gjeolog.

Nisur nga sa parashtruam më sipër, Komision gjykon se pretendimi i ankimuesit qëndron, pasi referuar seksionit “PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME” të dokumentit “Raporti gjeologjik” të hartuar nga specialistë të fushës kërkohet që për shkak të karakteristikave të veçanta që ka terreni ku do të kryhen punimet objekt prokurimit prania e specialistit gjeolog është i nevojshëm, ndërkohë që kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorit ekonomik ofertues në stafin inxhinierik të një inxhinier hidrogeolog është një kërkesë e dublikuar sepse në të njëjtën kohë ë këtë kriter kualifikues autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatorit ekonomik ofertues të ketë në stafin kryesorë si drejtues teknikë dhe të pasqyruar në licënsën profesionale personat të diplomuar në fushat si në vijim: “1 (një) Inxhinier Gjeodet ose Topograf ose Markshajder dhe 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik.”, duke e përmbushur rekomandimin e specialistëve të fushës, si dhe duke përmbushur argumentat e dhënë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor.

Përsa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, duke hequr kërkesën që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në stafin inxhinierik 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog.

Përsa më sipër, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues “METEO” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “METEO” SHPK përsa i përket modifikimit të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, Komisioni vëren se;

III.3.1. Në shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.8 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 20 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues 10-20 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	copë 2	Në pronësi ose me qira
Makeri për skarifikim	copë 1	Në pronësi ose me qira

<i>Grejder</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Rul (kompresor) me vibrim</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Autobot</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Autobitumatriçe</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Parangrohes 3000 liter</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Kaldaje bitumi 10000 litër</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Rul thike</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Eskavator 2 m3</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Vinc ekskavator</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Ekskavator batipal 1.8 ton</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Autovinc deri 5 ton</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Ekskavator krahqjatë</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Minieskavator / minifadrome</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Ekskavator me paisje shitesë për ngulje palankola</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Palankola metalike</i>	<i>50 ton</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Aparatura për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metode me goditje (me pjate)</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Fabrike betoni</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira, kontrate furnizimi</i>
<i>Freze asfalti</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Rrul gome - hekur mbi 15 ton</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Gjenerator</i>		
<i>Tokmak</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve të domosdoshme në kantier</i>		
<i>Kokore</i>	<i>copë 60</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Jeleke</i>	<i>copë 60</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Tabela sinjalizuese rrugore</i>	<i>copë 20</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra</i>	<i>copë 5</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Prozhektorë ndriçimi</i>	<i>copë 5</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Kulle ndricimi</i>	<i>copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Kuti ndihme e shpejtë</i>	<i>copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti;

- f) *Çertifikatë transporti nga njësia vendore;*
- g) *Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij*
 - *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:*
 - a) *Kontrata e qerasë*
 - b) *Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
 - c) *Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)*
 - d) *Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
 - e) *Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);*
 - f) *Çertifikatë transporti nga njësia vendore;*
 - g) *Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij*

- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)*
- *Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).*
- *Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive.*
- *Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*
- *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.*

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

III.3.2. Në procesverbalin "PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM" të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit”.

III.3.3. Në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin e zërave të punimeve objekt prokurimi, si vijon:

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
		1. PUNIME SHITESASH				
1	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	119,88442		
2	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur engjeshur me makineri	m2	155		
3	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	145		
4	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	52		
5	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	52		
6	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	94		

7	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	235		
8	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges,perhapur e ngjeshur me makineri	m3	1672		
9	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	216		
10	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	94		
11	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	94		
12	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	3036		
13	3.212/fd	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	3036		
14	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	3036		
15	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	1114		
16	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	911		
		SHUMA 1:				
		2. PUNIME SHITESASH 2				
17	2.261	Shtrese rere	m3	382		
		SHUMA 2:				
		3. PUNIME GERMIMI				
18	3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	1493,122		
19	3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	3711		
20	3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	10443		
		SHUMA 3:				
		4. PUNIME ASFALTIMI				
21	3.213	Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri	m2	88		

22	3.213	Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri	m2	94		
23	3.213	Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri	m2	3036		
		SHUMA 4:				
		5. ANALIZA TEKNIKE TE REJA 4				
24	4.19	Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.	ml	1196		
		SHUMA 5:				
		6. ANALIZA JASHTE LISTE				
25	An 3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	2504		
26	An-PL	F.V. Palankola metalike tip Larsen 603 K	m2	1445		
27	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi boksen beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	1320		
28	An.B	Furnizim vendosje box beton/arme 1800x1800 mm	ml	281		
29	An-P4	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=30cm	copë	7		
30	An- 3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	5282,74347		
31	An-PL	F.V Palankola per mbrojtjen e skarpatave hmes =3.74 m	m2	3323		
32	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi boksen beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	941		
33	An-B	Furnizim vendosje box beton/arme 2000x2000 mm	ml	362		
34	An-P5	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=40cm	copë	4		
35	An 3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	11354		

36	An-PL	F.V Palankola per mbrojtjen e skarpatave hmes =3.74 m	m2	6238		
37	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi boksen beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	2502		
38	An-8	Furnizim vendosje box beton/arme 2400x2000 mm	ml	834		
39	An-5	Pusete deri ne 2.5-3.5 m thellesi t=40cm	copë	1		
40	An-P5	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=40cm	copë	9		
		SHUMA 6:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Totali						

III.3.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “METEO” ShPK Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, ka argumentuar si më poshtë vijon;

“Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik për lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për mjetet dhe paisjet e nevojshme, sqarojmë se për përcaktuar mjetet/makineritë e nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

- **Parangrohës 3000 litër** i referohet analizës 3.213 “Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Kaldajë bitumi 10000 litër**, i referohet analizës 3.213 “Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Rul thikë** i referohet analizës 4.190 “Prerje asfalti me disk, në të dy anët”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Ekskavator 2.0 m3** i referohet analizës 3.164/1a “Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Vinç ekskavator** i referohet analizës An-3.69a “**Gërmim për kanale gjërësi deri në 3.0 m toke të zakonshme me praninë e ujrave nëntokësore deri në thellësinë 4 m >**”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Ekskavator batipal 1.8 ton** i referohet analizës An-PL F.V. “Palankola metalike tip Larsen 603 K >”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Ekskavator me paisje shtesë për ngulje palankola** i referohet analizës An-PL F.V. “Palankola metalike tip Larsen 603 K >”. Sasia 1 (një) copë i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.”.

III.3.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.3.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.7. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.3.9.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*” të shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, për heqjen e kërkesës së autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë 1 (një) Parangrohës 3000 litër, 1 (një) Kaldajë bitumi 10000 litër, 1 (një) Rul me thikë dhe 1 (një) Eskavator 2 m³, Komisioni i Shyqrtimit të Ankesave me shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “*Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, drejtuar ankimuesit ka argumentuar kërkesën e mësipërme për mjetet e sipërpërmendura, duke ju referuar analizave teknike të zërave të punimeve, ku për realizimin e zërit të punimit “3.213 “*Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri*” janë të nevojshme disponimi dhe përdorimi 1 (një) Parangrohës 3000 litër, 1 (një) Kaldajë bitumi 10000 litër, ku për realizimin e zërit të punimit “4.190 “*Prerje asfalti me disk, në të dy anët*” është e nevojshme disponimi dhe përdorimi 1 (një) Rul me thikë dhe për realizimin e zërit të punimit “3.164/1a “*Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri*” është e nevojshme disponimi dhe përdorimi 1 (një) Eskavator 2 m³.

Lidhur me përcaktimin e nevojës për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e zërave të punimeve objekt prokurimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mbështetur në realacionin teknik, projektin e zbatimit të objektit të prokurimit, grafikun e realizimit të punimeve, si dhe referuar zërave të punimeve të përcaktuara në preventiv duhet të bëjë një analizë të thelluar teknike të këtyre zërave sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.04.2023 “*PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM*”, duke identifikuar njërin prej katër elementeve të strukturës së kostos së këtyre zërave të punimeve si në vijim: “ç) shpenzimet për makineritë”, duke

përcaktuar nevojën për disponimin e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve, duke përcaktuar llojin e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve, si dhe duke përcaktuar sasinë e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve e kualifikimin profesional të punonjësve të kualifikuar që janë të nevojshëm për realizimin e këtyre punimeve në raport me grafikun e punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Komisioni referuar pretendimit të ankimuesit, argumentimeve të komisionit të shqyrtimit të ankesës, preventivit të punimeve ku janë përcaktuar zërat e punimeve të sipërpërmendura, si dhe nisur nga analizat teknike të këtyre zërave të punimeve të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.04.2023 *“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM”*, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor që operatoët ekonomikë ofertues të disponojnë për disponimin e 1 (një) Parangrohës 3000 litër, 1 (një) Kaldajë bitumi 10000 litër, 1 (një) Rul me thikë dhe 1 (një) Eskavator 2 m³ është një kërkesë në përputhje me natyrën e punimeve objekt prokurimi dhe me zërat e preventivit të publikuar, pasi referuar analizës teknike të këtyre zërave të punimeve referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.04.2023 *“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM”*, disponimi dhe përdorimi i këtyre mjeteve dhe pajisjeve është i domosdoshëm për realizimin e zërave të punimeve të sipërpërmendura.

Për më tepër, Komisioni gjykon se ankimuesi në pretendimin e tij nuk ka dhënë asnjë argument teknik, lidhur me faktin se këto mjete dhe pajisje nuk janë të nevojshme për realizimin e zërave konkret të preventivit të publikuar.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron..

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit *“METEO”* SHPK nuk qëndron.

III.3.9.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 *“Aftësitë teknike dhe profesionale”* të shtojcës 7 *“FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, për heqjen e kërkesës së autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë 1 (një) Vinç ekskavator, 1 (një) Ekskavator batipal 1.8 ton dhe 1 (një) Ekskavator me paisje shtesë për ngulje palankola, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 *“Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”*, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, drejtuar ankimuesit ka argumentuar kërkesën e mësipërme për mjetet e sipërpërmendura, duke ju referuar analizave teknike të zërave të punimeve, ku për realizimin e zërit të punimit *“An-3.69a “Gërmim për kanale gjërësi deri në 3.0 m toke të zakonshme me praninë e ujrave nëntokësore deri në thellësinë 4 m >”* është i nevojshëm disponimi dhe përdorimi 1 (një) Vinç ekskavator, dhe për realizimin e zërit të punimit *“An-PL F.V. “Palankola metalike tip Larsen 603 K >”* është e nevojshme disponimi dhe

përdorimi 1 (një) Ekskavator batipal 1.8 ton dhe 1 (një) Ekskavator me paisje shtesë për ngulje palankola.

Lidhur me përcaktimin e nevojës për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e zërave të punimeve objekt prokurimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mbështetur në realacionin teknik, projektin e zbatimit të objektit të prokurimit, grafikun e realizimit të punimeve, si dhe referuar zërave të punimeve të përcaktuara në preventiv duhet të bëjë një analizë të thelluar teknike të këtyre zërave sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.04.2023 “*PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM*”, duke identifikuar njërin prej katër elementeve të strukturës së kostos së këtyre zërave të punimeve si në vijim: “*ç) shpenzimet për makineritë,*”, duke përcaktuar nevojën për disponimin e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve, duke përcaktuar llojin e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve, si dhe duke përcaktuar sasinë e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve e kualifikimin profesional të punonjësve të kualifikuar që janë të nevojshëm për realizimin e këtyre punimeve në raport me grafikun e punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Komisioni referuar pretendimit të ankimuesit, argumentimeve të komisionit të shqyrtimit të ankesës, preventivit të punimeve ku janë përcaktuar zërat e punimeve të sipërpërmendura, konstaton se analiza teknike e këtyre zërave të punimeve nuk janë të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.04.2023 “*PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM*”, ndonëse në nënin 12 të këtij vendimi përcaktohet se: “*Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit nëpërmjet shërbimit të dedikuar elektronik në portalin unik qeveritar s-Albania, paraqesin analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologji të reja, të përdorura prej tyre, për të cilat nuk ekziston një analizë teknike e çmimit në manualin elektronik. Analizat teknike paraqiten në përputhje me metodologjinë e parashikuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.*”, duke përcaktuar që për teknologji të reja entet publike duhet të publikojnë analizën teknike të zërit të punimit për realizimin e të cilit po përdoret një teknologji e re.

Komisioni referuar pretendimit të ankimuesit, argumentimeve të komisionit të shqyrtimit të ankesës, si dhe preventivit të punimeve ku janë përcaktuar zërat e punimeve “*An-3.69a “Gërmim për kanale gjërësi deri në 3.0 m toke të zakonshme me praninë e ujrave nëntokësore deri në thellësinë 4 m >” dhe “An-PL F.V. “Palankola metalike tip Larsen 603 K >”*”, gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar analizën teknike të zërave të punimeve të sipërpërmendura, pasi analizat teknike të këtyre zërave nuk përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.04.2023 “*PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM*”, pasi autoriteti kontraktor ka parashikuar një teknologji të re për

realizimin e zërave të punimev, ndaj autoriteti kontraktor, duhet të argumentojë teknikisht kërkesën për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të mjeteve dhe pajisjeve të sipërpërmendura, duke publikuar analizën teknike të zërave të punimeve të sipërpërmendura.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht referuar analizës teknike të zërave të punimeve të kërkesës për disponimin e 1 (një) Vinç ekskavator, 1 (një) Ekskavator batipal 1.8 ton dhe 1 (një) Ekskavator të përmendur në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*” të shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të kundërt duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri kualifikues, duke hequr kërkesën për disponimin e 1 (një) Vinç ekskavator, 1 (një) Ekskavator batipal 1.8 ton dhe 1 (një) Ekskavatori.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “METEO” SHPK qëndron pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “METEO” SHPK përsa i përket modifikimit të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*” të Shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, Komisioni vëren se;

III.4.1. Në shtojcën 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.2 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:*

NP - 1 B *Punime gërmimi në tokë*

NP - 4 A *Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale*

NP - 5 A *Punime nentokesore, ura dhe vepra arti*

NP- 12A *Punime të inxhinierisë mjedisore*

Për punimet speciale të ndërtimit :

NS - 8 D *Ndertime betonarme parafabrikat, struktura metalike*

NS - 9 B *Punime strukturore speciale*

NS -18 A *Punime topogjeodezike*

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.”.

III.4.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Referuar kapitullit të germimeve sipas parashikimit të projekt preventivit	B	21-50 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Referuar gjithë punimeve në rrugë.	A	0-20 milion
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Referuar Punimeve të veprave të artit, punimet e beton armese sipas parashikimit në projekt preventiv	A	0-20 milion
NP- 12	Punime të inxhinierisë mjedisore	Referuar punimeve të inxhinierisë mjedisore, Përfshin gjithë punimet në rrugë.	A	0-20 milion
NS-8	Ndërtime betonarme parafabrikat, struktura metalike	Referuar në preventiv – Punime Betoni dhe Betonarme, Punime Hekur Betoni	D	101-200 mln
NS-9	Punime strukturore speciale	Referuar në preventiv – Palankola për mbrojtjen e skarpave etj	B	21-50 mln
NS-18	Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.	A	0-20 milion

III.4.3. Në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin e zërave të punimeve objekt prokurimi, si vijon:

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
		1. PUNIME SHITESASH				
1	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	119,88442		
2	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur engjeshur me makineri	m2	155		
3	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	145		
4	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	52		
5	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	52		
6	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	94		
7	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	235		
8	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges,perhapur e ngjeshur me makineri	m3	1672		
9	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	216		
10	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	94		
11	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	94		
12	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	3036		
13	3.212/fd	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	3036		
14	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me	m2	3036		

		<i>makineri</i>				
15	3.211	<i>Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri</i>	<i>m2</i>	1114		
16	3.164/1a	<i>Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri</i>	<i>m3</i>	911		
		SHUMA 1:				
		2. PUNIME SHITESASH 2				
17	2.261	<i>Shtrese rere</i>	<i>m3</i>	382		
		SHUMA 2:				
		3. PUNIME GERMIMI				
18	3.158/3a	<i>Transport dheu me auto deri 3.0 km</i>	<i>m3</i>	1493,122		
19	3.158/3a	<i>Transport dheu me auto deri 3.0 km</i>	<i>m3</i>	3711		
20	3.158/3a	<i>Transport dheu me auto deri 3.0 km</i>	<i>m3</i>	10443		
		SHUMA 3:				
		4. PUNIME ASFALTIMI				
21	3.213	<i>Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri</i>	<i>m2</i>	88		
22	3.213	<i>Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri</i>	<i>m2</i>	94		
23	3.213	<i>Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri</i>	<i>m2</i>	3036		
		SHUMA 4:				
		5. ANALIZA TEKNIKE TE REJA 4				
24	4.19	<i>Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.</i>	<i>ml</i>	1196		
		SHUMA 5:				
		6. ANALIZA JASHTE LISTE				
25	An 3.69/b	<i>Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m</i>	<i>m3</i>	2504		
26	An-PL	<i>F.V. Palankola metalike tip Larsen 603 K</i>	<i>m2</i>	1445		

27	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi baksin beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	1320		
28	An.B	Furnizim vendosje box beton/arme 1800x1800 mm	ml	281		
29	An-P4	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=30cm	copë	7		
30	An-3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	5282,74347		
31	An-PL	F.V Palankola per mbrojtjen e skarpatave hmes =3.74 m	m2	3323		
32	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi baksin beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	941		
33	An-B	Furnizim vendosje box beton/arme 2000x2000 mm	ml	362		
34	An-P5	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=40cm	copë	4		
35	An 3.69/b	Germim per kanale gjeresi deri ne 3.0 m toke te zakonshme me pranine e ujrave nentokesore deri ne thellesine 4 m	m3	11354		
36	An-PL	F.V Palankola per mbrojtjen e skarpatave hmes =3.74 m	m2	6238		
37	An-8	Mbushje me material te granular, anash dhe mbi baksin beton-arme sipas seksionit terthor tip	m3	2502		
38	An-8	Furnizim vendosje box beton/arme 2400x2000 mm	ml	834		
39	An-5	Pusete deri ne 2.5-3.5 m thellesi t=40cm	copë	1		
40	An-P5	Pusete deri ne 3.5-4.5 m thellesi t=40cm	copë	9		
		SHUMA 6:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma TVSH (20%)						

Shuma me TVSH	
Totali	

III.4.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “METEO” ShPK Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 17458 prot, datë 23.10.2025 “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokolli 2958/2025”, protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot, datë 24.10.2025, ka argumentuar si më poshtë vijon;

“Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik për lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për licencat e përcaktuara, sqarojmë:

Sipas VKM 42 DATË 16.01.2008, ku citohet se :

N.S — 8 Ndërtim parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrike prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara

LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI
A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë
F	401 – 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

Duke ju referuar preventivit dhe zërave që përfshihen në punime strukturore (box betonarme, palankola metalike, puseta, etj.), vlera e këtyre punimeve zë rreth 75 % e vlerës totale, të cilat përbëhen nga punime betonarme / parafabrikat / struktura metalike, atëherë licenca NS-8D është plotësisht e justifikuar.

Licenca NS-8 B zakonisht mbulon vepra të vogla (objekte me kompleksitet më të ulët ose vlerë më të vogël të punimeve strukturore).

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.”.

III.4.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.4.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.7. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistroheshin në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.4.8. Në KREUN III “KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET” pika 1 dhe pika 2, Lidhja 2, Lidhja 3 dhe Lidhja 4, të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet se:

[...]

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

c) Shfuqizuar.

ç) Shfuqizuar.

d) Autoriteti kontraktues kërkon ndërprerjeje e punimeve dhe prishjen e kontratës për çdo vonesë në grafikun e punimeve, që rrezikon përfundimin e punimeve në afatin përfundimtar, të përcaktuar në kontratën e nënshkruar. Në këtë rast edhe për moskryerje të punimeve sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën “c” kërkohet heqja e licencës për shoqëri ndërtuese, në përputhje me këtë vendim dhe përjashtimin e saj nga prokurimet publike, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

2. Elementet e licencës:

a) Licenca përmban këto elemente:

I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2);

II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4);

III. Numrin e identifikimit;

IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni);

V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë;

VI. Selinë;

VII. Afatin e vlefshmërisë;

VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit;

IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).

b) Formulari i licencës miratohet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.

LIDHJA 2

TABELA

Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit në ndërtim

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

<i>N.S – 1</i>	<i>Punime për prishjen e ndërtimeve.</i>
<i>N.S- 2</i>	<i>Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.</i>
<i>N.S- 3</i>	<i>Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).</i>
<i>N.S.- 4</i>	<i>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.</i>
<i>N.S - 5</i>	<i>Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.</i>
<i>N.S – 6</i>	<i>Sinjalistika rrugore jondriçuese.</i>
<i>N.S –7</i>	<i>Barriera dhe mbrojtje rrugore.</i>
<i><u>N.S – 8</u></i>	<i><u>Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.</u></i>
<i>N.S – 9</i>	<i>Punime strukturore speciale.</i>
<i>N.S – 10</i>	<i>Shtresa dhe mbistruktura speciale.</i>
<i>N.S – 11</i>	<i>Punime mbi shina dhe traversa.</i>
<i>N.S - 12</i>	<i>Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.</i>
<i>N.S - 13</i>	<i>Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.</i>
<i>N.S – 14</i>	<i>Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.</i>
<i>N.S- 15</i>	<i>Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.</i>
<i>N.S – 16</i>	<i>Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.</i>
<i>N.S – 17</i>	<i>Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.</i>
<i>N.S – 18</i>	<i>Punime topogjeodezike.</i>
<i>N.S.- 19</i>	<i>Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.</i>
<i>N.S.- 20</i>	<i>Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.</i>

LIDHJA 3

SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE

N.P. 8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që i përkasin terminaleve “ujore” ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujore, ujësjellsat nënujore, vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura.

LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI
<i>A</i> <i>(edhe për herë të parë)</i>	<i>0- 20 milion lekë</i>
<i>B</i>	<i>21- 50 milion lekë</i>
<i>C</i>	<i>51 – 100 milion lekë</i>
<i>D</i>	<i>101 – 200 milion lekë</i>
<i>E</i>	<i>201 – 400 milion lekë</i>
<i>F</i>	<i>401 – 800 milion lekë</i>
<i>G</i>	<i>mbi 800 milion lekë</i>

III.4.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.4.10. . Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*” të shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, për uljen e klasifikimit të kategorisë së punimeve “*N.S – 8 Ndërtimë parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri*” nga klasifikimi në nivelin “D” në

klasifikimin në nivelin “B”, konstaton se referuar procesverbalit “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar nivelin e klasifikimit “D” të kësaj kategorie license, duke ju referuar vlerës së punimeve të betonit, betonarmesë dhe hekur-betoni të pasqyruara në preventivin e punimeve object prokurimi, si dhe Lidhjes 4 “*Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi*” të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i argumentave të sipërpërmendura, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar zërat konkretë të preventivit të cilat përfshihen në kategorinë e punimeve “*N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri*” dhe për më tepër nuk ka argumentuar se sa është vlera totale monetare e këtyre zërave të punimeve krahasuar me vlerën e kalsifikimeve të përcaktuara në Lidhjes 4 “*Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi*” të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në përcaktimin e klasifikimit të një kategorie punimi, duhet që fillimisht të identifikojë zërat konkretë të projekt-preventivit të hartuar, të cilët përfshihen në një kategori punimesh, duke ju referuar përkrahimit përkatës të kategorisë sipas përcaktimeve të Lidhja 3 “*SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE*” të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar dhe pas identifikimit të zërave të punimeve duhet që të klasifikojë kategorinë e punimeve duke përllogaritur vlerën totale monetare të zërave të punimeve në projekt-preventiv dhe duke përzgjedhur klasifikimin përkatës referuar Lidhjes 4 “*Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi*” të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Komisioni referuar pretendimit të ankimesit, argumentimeve të autoritetit kontraktor, si dhe preventivit të punimeve ku janë përcaktuar zërat e punimeve, gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka arritur që të argumentojë vendosjen e klasifikimit “G” për kategorinë e licensës “*N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri*”, pasi nuk ka identifikuar zërat konkretë të preventivit që përfshihen në këtë kategori punimesh dhe nuk ka përllogaritur vlerën totale të këtyre zërave të punimeve dhe në përfundim nisur nga kjo vlerë referuar Lidhjes 4 “*Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi*” të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,*

që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, të përcaktojë klasifikimin përkatës të kategorisë së punimeve.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor referuar sa më sipër duhet të argumentojë klasifikimin “D” për kategorinë e punimeve “N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri” të përcaktuar në kriterin kualifikues në pikën 2.3.2 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të shtojcës 7 “**FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të kundërt duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri kualifikues sipas pretendimit të ankimuesit, duke e ulur klasifikimin e kësaj kategorie punimesh nga klasifikimi “D” në klasifikimin “B”.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “METEO” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “METEO” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “METEO” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës

deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “METEO” ShPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

